



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.130/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Nenad Laziç dhe Rafet Haxhaj anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me ankesën e Instituti për Gazetari Hulumtuese (BIRN), me seli në Prishtinë paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Vushtrri, për shkak të bërjes së fushatës zgjedhore me të mitur, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 10.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa ZL.Anr.130/2017 e datës 06.10.2017 e parashtruar nga Instituti për Gazetari Hulumtuese (BIRN), me seli në Prishtinë, me të cilën kërkohet që ti shqiptohet dënimi me gjobë subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Vushtrri, për shkak të thyerjes së Kodit të Mirësjelljes.

A r s y e t i m

Me datën 06.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga BIRN, me të cilën pretendon se me datën 04.10.2017, rreth orës 10:00, kandidati për kryetar të komunës së Vushtrrisë Xhafer Tahiri nga radhët e subjektit politik LDK, ka postuar fotografi në rrjetin social Facebook, lidhur me rastin e vizitës në nëndegën të Kalaja, ku janë përfshirë fëmijë të mitur. Me këtë rast parashtruesi i ankesës pretendon se është shkelur neni 85 pika 1 e LZP-së dhe neni 5.2 i Rregullës Zgjedhore të KQZ-së. (Rregulla nr. 13/2013).

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur një fotografi të printuar lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të datës 07.10.2017, subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), e konteston si të pa bazuar ankesën, sepse lidhur me këtë rast nuk ka asnjë shkelje nga ana e kandidatit për Kryetar të Komunës së Vushtrrisë, pasi që kandidati gjatë rrugës ka bërë foto pranë një foshnje, por jo i mitur. Më tutje ka shtuar se nuk ka bërë asnjë ftesë publike për ta votuar që ka të bëjë lidhur me zgjedhjet. PZAP-in e ka informuar se lidhur me këtë rast kemi kërkuar nga kandidati për kryetar të komunës së Vushtrrisë Xhafer Tahiri nga radhët e subjektit politik LDK, që të largoj foton, me qëllim që e njëjta mos të keqkuptohet apo keqinterpretohet.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e pabazuar

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës lidhur me shkeljen e pretenduar të Kodit të Mirësjelljes nga ana e subjektit politik LDK, Paneli i vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se, veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të Kodit të Mirësjelljes në kuptim të dispozitës së nenit 33 pika b) të LZP-së, për arsye se kandidati për kryetar të komunës së Vushtrrisë Xhafer Tahiri nga radhët e subjektit politik LDK nuk ka bërë fushatë me të mitur, pasi që i njëjti ka qenë duke kaluar rrugës dhe po ashtu nuk vërtetohet me asnjë provë se ka pasur tubim publik, lidhur me rastin në fjalë.

Nga arsyet e theksuar më lartë dhe duke u bazuar në nenin 118 par.1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

ZL.Anr.130/2017 më datën 10.10.2017



Kryesuesi i Panelit
Zyhdë Haziri

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.